



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0780

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Brajshori Kryetare, Isa Hasani Anetar dhe Vedat Poterqoi Anetar duke vendosur sipas ankesës së OE “PBC” SH.P.K., kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri-tender Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemi BHIS-3” me numër të prokurimit 206-25-6449-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “MINISTRIA E SHËNDETËSISË”, më 17/10/2025, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e “PBC” SH.P.K., me nr. 2025/0780, e datës 14/08/2025, 14/08/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri-tender Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemi BHIS-3”, me numër të prokurimit 206-25-6449-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “MINISTRIA E SHËNDETËSISË”

2. Anulohet njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri-tender Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemi BHIS-3”, me numër të prokurimit 206-25-6449-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “MINISTRIA E SHËNDETËSISË”. AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 17.07.2025, "MINISTRIA E SHËNDETËSISË", në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Ri-tender Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemi BHIS-3" me nr.prokurimi: 206-25-6449-2-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 432,000.00 €.

Me 01.08.2025, OE "PBC" SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 05.08.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 14.08.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "PBC" SH.P.K., me nr. 2025/0780 lidhur me aktivitetin "Ri-tender Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemi BHIS-3" me numër të prokurimit 206-25-6449-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "PBC" SH.P.K., janë parashtruar si në vijim: 1.Autoriteti Kontraktues ka shkelur këto dispozita të Ligjit nr. 04/L-042, Ligjit Nr. 04/L- 237, Ligjit Nr. 05/L-068 dhe Ligjit Nr. 05/L-092:a)paragrafin 1 të nenit 1 (duke MOS përcaktuar detyrimet që do të përmbushen nga operatorët ekonomik);b)pikën i) e paragrafin 1 të nenit 9 (duke MOS përcaktuar llojin dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të autoritetit kontraktues që prokurimi i propozuar parashesh t'i plotësojë);c)pikën iii) e paragrafin 1 të nenit 9 (duke MOS përcaktuar specifikimet e propozuara funksionale të secilit objekt që do të përfshihet nga një kontratë e tillë);d)paragrafin 1 të nenit 27 (duke MOS përpiluar dosjen e tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj dhe duke MOS përcaktuar në dosjen e tenderit të gjitha specifikimet teknike të zbatueshme)e)paragrafin 8 të nenit 28 (duke MOS paraqitur kërkesa ekzekutuese dhe funksionale të sakta në mënyrë që t'u mundësojë tenderuesve që të përcaktojnë lëndën kryesore të kontratës).2) Faktet dhe argumentet tonaAutoriteti Kontraktues, as në dosjen e tenderit e as në sqarimet e datës 29.07.2025, nuk ka definuar punën, vëllimin dhe kompleksitetin që duhet të kryhen. Këtë e argumentojmë edhe me përgjigjet e vetë Autoritetit Kontraktues, ku deklarohet se:1.Nuk ka një paramasë të saktë për sasinë e avancimit apo zhvillimit të moduleve ekzistuese dhe atyre të reja2.Numri i trajnimeve dhe ri-trajnimeve do të definohet gjatë zbatimit;3.Numri i moduleve do të përcaktohet gjatë fazës së analizës;4.Numri i nën-moduleve nuk është përcaktuar paraprakisht;5."Avancimi" përfshin përmirësim të pjesshëm dhe ridizajnim të plotë, varësisht nevojave;6.Modulet e reja do të identifikohen gjatë zbatimit;7.Ndërlidhjet me sistemet e jashtme do të përcaktohen me detaje gjatë zbatimit.

Prova: Aneks 1 – Specifikimet teknike të dosjes së tenderit dhe sqarimet e datës 29.07.2025. Nga kjo rezulton qartë se AK nuk ka përmbushur detyrimet ligjore të përcaktuara qartazi në dispozitat përkatëse, duke lënë procesin e prokurimit në gjendje të paqartë, subjektive dhe të paefektshme për pjesëmarrje konkurruese të barabartë. Pavarësisht kësaj, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim, në kundërshtim me dispozitat ligjore, përkatësisht nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik, duke mos shqyrtuar pretendimet tona, ku në vendimin e datës 05.08.2025, për këtë pretendim ka dhënë këtë arsytim: “Në kërkesën tuaj për rishqyrtim, ju keni pretenduar lidhur me paqartësitë në dokumentacion, vlerësimin financiar, si dhe shkelje të supozuara të dispozitave të LPP-së. AK vlerëson se ky pretendim lidhur me mungesën e saktësisht të vëllimit të punëve, numrit të moduleve, apo trajnimeve, është i paqëndrueshëm dhe i pabazuar në realitetin e kontratave të natyrës së zhvillimit të softuerëve. Dokumentacioni i tenderit është strukturuar mbi këtë bazë, në përputhje me nenet 27 dhe 28 të LPP-së-Praktika standarde e projekteve të teknologjisë informative përfshin metodologjinë inkrementale (agile), ku specifikat përfundimtare, përfshirë numrin e moduleve, detajet e trajnimeve dhe ndërveprimet teknike, saktësohen gjatë zbatimit në bashkëpunim OE dhe AK.- Autoriteti Kontraktues ka deklaruar qartazi në dokumentacion se puna do të zhvillohet sipas nevojave të paraqitura gjatë fazave të projektit, gjë që është e zakonshme dhe legjitime në projekte të kësaj natyre. Gjate implementimit të kontratës mund të ketë me shume ose pak module, meqenëse kontrata është kornizë për 36 muaj, sasia e parashikuar është vetëm sasi indikative dhe devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është +/- 30% e vlerës së kontratës.”

Ne e KUNDËRSHTOJMË këtë arsytim për faktin se: 1. Ligji kërkon përcaktime minimale, pavarësisht metodologjisë – Nen. 27 par. 1 dhe Nen. 28 par. 8 LPP kërkojnë që dosja e tenderit të përmbajë kërkesa funksionale dhe ekzekutive të sakta. Metodologjia “agile” nuk e përjashton këtë detyrim ligjor. 2. Edhe pse e njëjta nuk është specifikuar në dosjen e tenderit, Metodologjia inkrementale (agile) nuk justifikon mungesën e specifikimeve në tender, sepse kjo metodologji nuk definon sasinë, vëllimin, kompleksitetin dhe dinamikën e implementimit të punëve në fazën e tenderimit, përkatësisht definimit të kostos dhe numrit të personelit. Për më tepër, metodologjia në këtë fazë është tërësisht e parëndësishme, sepse: o Agile është një qasje që mundëson përshtatje gjatë zbatimit, por gjithmonë mbi bazën e një scope (fushë veprimi) të qartë dhe objektivave të përcaktuara para fillimit të punës, respektivisht në specifikimet teknike të Dosjes së Tenderit, të cilat janë të padefinuara. o Çdo projekt agile fillon me një product backlog dhe definition of done, ku përcaktohen objektivat, funksionalitetet minimale, kriteret e pranimit, afatet dhe prioritetet kryesore. Mirëpo, në dosjen e tenderit dhe sqarimet shitesë mungojnë parakushtet për definimin e product backlog dhe definition of done. Pikërisht për këtë arsye adresojmë dhe argumentojmë ankesën. o Edhe me qasje agile, këto elemente fillestare janë të domosdoshme për të llogaritur koston, për të planifikuar burimet dhe për të siguruar konkurrencë të barabartë në tenderim. o AK ka shpallur një kontratë pa përcaktuar as objektivat minimale, as volumet orientuese, as dinamikën, duke lënë gjithçka për t’u përcaktuar gjatë zbatimit të projektit. Analogjia e kësaj është sikurse ta nisim ndërtimin e një spitali, ndërsa gjatë implementimit, pra pas nënshkrimit të kontratës vendosim se sa metra katror do të ketë, sa salla operimi do të ketë, sa dhoma pacientësh do të ketë, si do të jenë ato, kur do të kryhen e një mori specifikimesh tjera që përveç vendosjes së operatorit ekonomik para një kolapsi financiar e rrezikon atë edhe me ndërprerje të kontratës dhe reperkusione tjera, të pa kuantifikueshme. 3. Paqartësia cenon parimin e barazisë – Nen. 1 par. 1 dhe Nen. 9 par. 1 pika i dhe iii LPP kërkojnë specifikime të barabarta për të gjithë ofertuesit. Pa këto, vetëm operatorët me informata paraprake kanë avantazh. 4. Termi “sasi indikative” nuk e justifikon mungesën e specifikimeve – Nen. 17 par. 1 LPP kërkon përcaktim të qartë të lëndës kryesore të kontratës. Një devijim +/- 30% në mungesë të parametrave konkretë krijon pasiguri të plotë për ofertuesit. 5. Praktikant e TI nuk anashkalojnë ligjin – Asnjë qasje metodologjike nuk mund të

zëvendësojë detyrimin ligjor për të përgatitur dokumentacion me kërkesa të qarta dhe të matshme.6.Provat nga vetë dokumentacioni – Përgjigjet e AK-së (29.07.2025) dëshmojnë mungesën e çdo parametri konkret për module, trajnime, nën-module dhe ndërlidhje teknike, duke e lënë objektin e kontratës të papërcaktuar.5) PërfundimNga sa me sipër, në çdo rrethanë, kjo situatë lë në pasiguri të plotë ofertuesit për:• Përgatitjen e një oferte të përgjegjshme dhe konkurruese;• Planifikimin e burimeve njerëzore dhe financiare;• Vlerësimin e riskut dhe kalkulimin e çmimeve2.Autoriteti Kontraktues ka shkelur këto dispozita të Ligjit nr. 04/L-042, Ligjit Nr. 04/L-237, Ligjit Nr. 05/L-068 dhe Ligjit Nr. 05/L-092:a)Pikën ii të paragrafit 1 të nenit 9 (duke parashikuar një vlerë financiare TË PASAKTË DHE TË PAQËNDRYESHME për kushtet përmbajtjesore të kontratës që do të jetë lëndë e prokurimit të planifikuar);b)Paragrafin 2 të nenit 9 (duke ndarë mjete të PA MJAFTUESHME financiare për prokurimin përkatës në shumë të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve që mund të dalin si rezultat i prokurimit);c)Paragrafin 1 të nenit 17 (duke MOS përfshirë të gjitha elementet e çmimit përfundimtar që mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, që do të paguhet nga autoriteti kontraktues për shërbimet dhe lëndët e tilla, duke përfshirë çfarëdo dhe të gjitha taksat, detyrimet dhe tarifatat e tjera).SEPSE:1.Autoriteti Kontraktues ka parashikuar vlerën e kontratës prej vetëm 432,000 euro, përfshirë TVSh-në, ose 366,101.69 euro, pa TVSh, përkundër se:(1)çmimet e tregut për inxhinierët e kërkuar në Dosjen e Tenderit, që plotësojnë kriteret e përzgjedhjes dhe kanë kompetencë profesionale të ofrojnë shërbimet e kërkuara (paçka as nuk dihet se çka do të implementohet – shih pretendimin ankimor të më sipërm), janë si në vijim:Një 1) Menaxher Projekti ? mbi €3,000 bruto në muaj x 36 muaj = €108,000Dy (2) Zhvillues Softueri ? mbi 2 x €2,500 bruto në muaj x 36 muaj = €180,000Dy (2) Zhvillues të databazave ? mbi 2 x €2,500bruto në muaj x 36 muaj = €180,000Një (1) Zhvillues të Web Shërbimeve dhe Web API-ve ? mbi €2,000 bruto në muaj x 36 = €72,000Katër (4) Staf për Trajnime Onsite ? mbi 4 x €800 bruto në muaj x 36 = €115,200Totali i pagave të inxhinierëve të kërkuar për periudhën e kontratës është së paku:€655,200, pa përfshirë tatimin në pagë, pa përfshirë shpenzimet operative, e aq më pak ndonjë profit minimal për operatorin ekonomik dhe pa përfshirë Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSh).Provë: Lista e pagave në Administratën Tatimore të Kosovës(2)fare nuk ka marrë për bazë ngritjen e pagave në sektorin e zhvillimit të softuerit, nga viti në vit, e të cilat kanë pësuar ngritje nga viti 2024 në vitin 2025, preh hiç më pak se 49.71%, referuar statistikave të Data4X. Ngjashëm pritet të ndodhë edhe gjatë vitit 2026, 2027 dhe 2028.Provë: <https://www.data4x.com/>(3)Në planifikimin e prokurimit për vitin 2025, për punët e totalit të këtij projekti janë alokuar 1.1 milion euro (500,000 € për zhvillim dhe avancim, 500,000 € për mirëmbajtje dhe 100,000 € për trajnime), një shumë që korrespondon me alokimin buxhetor të viteve paraprake që ishte 1,070,000 euro, por NUK e ka ndarë vëllimin e punëve në proporcion me ndarjet e buxhetit. E, përveç kësaj, vëllimi i punëve është i matshëm dhe mund të shtohet në vazhdimësi, në kuadër të shumës maksimale të buxhetit prej vetëm 432,000 EUR. Ndërkohë, vetëm për zhvillimin e sistemit LIS (Laboratory Information System), i cili në pjesën më të madhe është i inkorporuar në Basic HIS (për të cilin po kërkojmë rishqyrtim), janë alokuar 1,221,000 euro. Për të dy këto sisteme, është ndarë një buxhet prej vetëm 432,000 euro, duke reduktuar vlerën për 81.14%.Provë: Planifikimi i Prokurimit për vitin 2025.(4)Për sisteme shumë më të vogla, shumë më pak komplekse dhe të qarta për nga fushëveprimi ka ndarë buxhet, siç vijon:(a)“Zhvillimi i modulit për IVF” ka dedikuar një buxhet prej 150,000€, edhe pse vëllimi i punës së këtij projekti nuk është as sa 10% e vëllimit të punës së këtij projektit kundër të cilit adresojmë kërkesë për rishqyrtim (Basic HIS).(b)Zhvillimi i modulit TMJISHP” ka dedikuar një buxhet prej 130,000€ edhe pse vëllimi i punës së këtij projekti nuk është as sa 10% e vëllimit të punës së këtij projektit kundër të cilit adresojmë kërkesë për rishqyrtim (Basic HIS).(c)“Zhvillimi I LIS” që për nga vëllimi i punëve është sa një nën-modul i Basic HIS (tashmë, në masë substanciale i inkorporuar në këtë projekt) ka ndarë buxhet prej 1,034,745.76€ pa TVSH, ndërsa për komplet mirëmbajtjen, 3 vjeçare të Basic HIS (këtij projekti që

adresojmë kërkesë për rishqyrtim) dhe për zhvillimin e 10 nën-sistemeve, ndërlidhjen e tyre me dhjetëra sosh, shkrirjen e disa sistemeve dhe mirëmbajtjen 24/7 të tyre ka ndarë rreth 30% të shumës së këtij buxheti.(d)“Trajnime për Stafin e SISH”, ka dedikuar një buxhet prej 100,000€, pavarësisht se vëllimi i punës është i barabartë me trajnimet që do të mbahen për Basic HIS. Ndërkohë, për mirëmbajtjen 3-vjeçare, zhvillimin e 10 nën-sistemeve, ndërlidhjen e tyre me dhjetëra të tjera, integrimin e disa sistemeve në Basic HIS, mirëmbajtjen 24/7 dhe trajnimin, është ndarë një buxhet katër herë më i lartë. Kjo nënkupton që për një nga dhjetëra kërkesat e Basic HIS në një projekt tjetër, është ndarë një buxhet përafërsisht 10 fish më i lartë.(e)“Ritender Mirëmbajtja e SW (Legacy Sistemeve)” ka dedikuar një buxhet prej 305,084.75€ pa TVSH, përkundër që vëllimi i punës nuk është as sa 1/3 e vëllimit të punës së projektit që tani prokurohet (Basic HIS).

Duke u bazuar në shkeljet e theksuara më sipër, në mangësitë e rënda të dokumentacionit të tenderit, në paqartësinë e kërkesave teknike, mungesën e përgjigjeve të plota ndaj pyetjeve të parashtruara, si dhe në disproporcionet ekstreme midis buxhetit të shpallur dhe realitetit financiar të projektit, konsiderojmë se procedura e tanishme e prokurimit është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik dhe parimet themelore të tij.Prandaj,

1.Të ndërpresë këtë procedurë të prokurimit në formën e tanishme, për shkak të mangësive serioze përmbajtjesore, teknike dhe buxhetore që e bëjnë atë të papërshtatshme për zbatim të ligjshëm dhe efektiv;2.Të përmirësojë rrënjësisht dokumentacionin e tenderit, duke: o specifikuar qartë kërkesat teknike dhe funksionale të projektit; o harmonizuar numrin e inxhinierëve të kërkuar me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të kërkuara; o siguruar përgjigje të plota, të qarta dhe të barabarta për të gjithë operatorët ekonomikë;1.Të caktojë një buxhet realist dhe të arsyeshëm, në përputhje me Ligjin për Buxhet dhe me kostot reale të tregut, duke u bazuar në të dhënat konkrete të Administratës Tatimore dhe/apo Trustit Pensional të Republikës së Kosovës;2.Të përfshijë në dosjen e tenderit një analizë të plotë të vlerës së projektit, përfshirë të gjitha elementet e çmimit përfundimtar (personel, pajisje, trajnime, mirëmbajtje, TVSH, tatim në pagë, etj.);3.Të aplikojë kritere të përzgjedhjes që janë të matshme, të ndërlidhura me fushëveprimin real të projektit dhe të eliminojë çdo formë të diskriminimit apo subjektivitetit;4.Të garantojë barazi në konkurrencë, transparencë dhe efikasitet në shpenzimin e fondeve publike, në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik, në Kosovë.Pavarësisht kësaj, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim, në kundërshtim me dispozitat ligjore, përkatësisht nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik, duke mos shqyrtuar pretendimet tona, ku në vendimin e datës 05.08.2025, për këtë pretendim ka dhënë këtë arsyetim:2. Lidhur me pretendimin për buxhet të pamjaftueshëm dhe jo të qëndrueshëm“Pretendimi mbi mospërputhjen e buxhetit është jo bindës për AK dhe jo i mbështetur në analizë objektive të kontratës. Përcaktimi i buxhetit është bërë nga AK në përputhje me parimet e racionalizimit të fondeve publike dhe me referencë në nevojat e tij reale, jo sipas kostove të deklaruara subjektivisht nga PBC SH.P.K.-Buxheti total për 36 muaj përfshin komponentë të shumtë dhe nuk mund të analizohet thjesht përmes kostos së pagave.-AK nuk është i detyruar të adoptojë çmime të sugjeruara nga operatorët ekonomikë, por të prokurojë në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme brenda fondeve publike në dispozicion.Krahasimet me projekte të tjera nuk janë bindës për AK, ne i konsiderojmë si joprofesionale dhe jashtë kontekstit specifik të këtij prokurimi.Askund te DT nuk është kërkuar që i gjithë stafi profesional i kërkuar sipas profileve të caktuara duhet të angazhohen permanent në këtë projekt dhe për 36 muaj. Edhe sikur ta kërkonim angazhim permanent, ne e dimë nga përvoja se një gjë e tillë nuk zbatohet nga ana e kompanive në projekte të tilla.”Ne e KUNDËRSHTOJMË këtë arsyetim për faktin se:1.Fare nuk janë shqyrtuar (sikurse e kërkon neni 108/A i LPP) argumentet dhe provat që kemi parashtruar. Në vend të shqyrtimit (dhe kundërshtimit nëse do të gjenin bazë dhe kundër

argumente), Autoriteti Kontraktues vetëm e konfirmon se:a.Vëllimi i punëve është i madh dhe përfshin komponente të shumtë. Dhe se nuk janë vetëm pagat që e përcaktojnë, por fare NUK trajton çështjen e kostos së pagave dhe argumenteve të parashtruara nga ana jonë;b.pretendon prokurim efikas dhe të qëndrueshëm, paqka nuk e ka definuar vëllimin, kompleksitetin dhe dinamikën punëve, e as nuk ka alokuar resurset financiare të nevojshme për to.c.fare nuk i ka krahasuar gjendjen e tregut, për më keq, as projektet e veta, dhe argumentet tjera që kemi parashtruar lidhur me ndarjet buxhetore.d.në projektet tjera paguan personel më shumë sesa nevojat dhe se u lejon kompanive tjera të mos e angazhojnë stafin në mënyrë permanente. Krahas tjerave, është pikërisht kjo praktikë që cenon barazinë në trajtim, transparencë, ekonomicitet dhe matje tjera që ne po kërkojmë të bëhët në fazën e tenderimit dhe të eliminohen skenarë që përbëjnë rrezik multidimensional për operatorët ekonomik, sic edhe kërkohet me nenet 7, 9, 17, 27 dhe 28 të Ligjit për Prokurim Publik.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “PBC” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues Ligji nr. 04/L-042, Ligji Nr. 04/L-237, Ligji Nr. 05/L-068 dhe Ligji Nr. 05/L-092, Neni 1, paragrafi 1, Neni 9, paragrafi 1, pika i), Neni 9, paragrafi 1, pika iii), Neni 27, paragrafi 1, Neni 28, paragrafi 8, Neni 9, paragrafi 1, pika ii), Neni 9, paragrafi 2, Neni 17, paragrafi 1, Neni 108/A. Bazuar në faktet dhe argumentet e sipërpërmendura, kërkojmë nga OSHp që ta konstatojë këtë shkelje ligjore dhe të urdhërojë AK-në të riformulojë dokumentacionin e tenderit me specifikime të qarta dhe të matshme.

Përgjigje e Autortitetit Kontraktues ndaj kërkesës për rishqyrtim:Përqiijet e Autoritetit Kontraktues në lidhje me pretendimet ankimore: E kemi shqyrtuar kërkesën tuaj për rishqyrtim dhe mund të konsiderojmë se pretendimi juaja ankimore janë të pa bazuar, për arsytet e sqaruara si ne vijim:1.Rreth pretendimeve për paqartësi në dokumentacionin e tenderitNë kërkesën tuaj për rishqyrtim, ju keni pretenduar lidhur me paqartësitë në dokumentacion, vlerësimin financiar, si dhe shkelje të supozuara të dispozitave të LPP-së.AK vlerëson se ky pretendim lidhur me mungesën e saktësisimit të vëllimit të punëve, numrit të moduleve, apo trajnimeve, është i paqëndrueshëm dhe i pabazuar në realitetin e kontratave të natyrës së zhvillimit të softuerëve.Dokumentacioni i tenderit është strukturuar mbi këtë bazë, në përputhje me nenet 27 dhe 28 të LPP-së.- Praktika standarde e projekteve të teknologjisë informative përfshin metodologjinë inkrementale (agile), ku specifikat përfundimtare, përfshirë numrin e moduleve, detajet e trajnimeve dhe ndërveprimet teknike, saktësohen gjatë zbatimit në bashkëpunim OE dhe AK.- Autoriteti Kontraktues ka deklaruar qartazi në dokumentacion se puna do të zhvillohet sipas nevojave të paraqitura gjatë fazave të projektit, gjë që është e zakonshme dhe legjitime në projekte të kësaj natyreGjatë implementimit të kontratës mund të ketë me shume ose pak module, meqenëse kontrata është kornizë për 36 muaj, sasia e parashikuar është vetëm sasi indikative dhe devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është +/- 30% e vlerës së kontratës.2.Lidhur me pretendimin për buxhet të pamjaftueshëm dhe jo të qëndrueshëmPretendimi mbi mospërputhjen e buxhetit është jo bindes për AK dhe jo i mbështetur në analizë objektive të kontratës. Përcaktimi i buxhetit është bërë nga AK në përputhje me parimet e racionalizimit të fondeve publike dhe me referencë në nevojat e tij reale, jo sipas kostove të deklaruar subjektivisht nga PBC SH.P.K.-Buxheti total për 36 muaj përfshin komponentë të shumtë dhe nuk mund të analizohet thjesht përmes kostos së pagave.-AK nuk është i detyruar të adoptojë çmime të sugjeruara nga operatorët ekonomikë, por të prokurojë në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme brenda fondeve publike në dispozicion.Krahasimet me projekte të tjera nuk janë bindes për AK, ne i konsiderojmë si joprofesionale dhe jashtë kontekstit specifik të këtij prokurimi.Askund te DT nuk është kërkuar që i gjithë stafi profesional i kërkuar sipas profileve të caktuara duhet të angazhohen permanent në këtë projekt dhe për 36 muaj. Edhe sikur ta kërkonim angazhim permanent, ne e dimë nga përvoja se

një gjë e tillë nuk zbatohet nga ana e kompanive në projekte të tilla.³Për pretendimin mbi shkeljet e dispozitave të LPP-sëPretendimet e OE janë të interpretuara në mënyrë të njëanshme dhe nuk përfaqësojnë shkelje reale të dispozitave ligjore. AK ka vepruar në përputhje me parimet themelore të LPP-së, përkatësisht nenet 7, 9, 17, 27 dhe 28, duke siguruar barazi dhe mosdiskriminim për të gjithë operatorët pjesëmarrës.Pretendimet për mungesë të qartësisë nuk qëndrojnë, pasi dokumentacioni është hartuar në mënyrë funksionale dhe sqarimet janë dhënë sipas procedurave të parashtruara me ligj.⁴Mbi pretendimin për dëme materialeNuk është prezantuar asnjë provë apo dokument që dëshmon dëme reale ose humbje të shkaktuara nga dokumentacioni i tenderit Kërkesa për kompensim është pa bazë faktike dhe nuk përmban vlerësim financiar të argumentuar.⁵PërfundimKërkesa për Rishqyrtim e PBC SH.P.K. është:-E pabazuar në fakte objektive;-Me interpretim të njëanshëm të ligjit;Dhe nuk ofron asnjë arsye të ligjshme për të ndërhyrë në procedurën e prokurimit.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP,OSHP me datë 15.08.2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0780/2025, ndërsa me datë 29.08.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2025/0780 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit sipas përgjigjeve të dhëna me lartë dhe të zgjasë afatin për ofertim

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësit dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “PBC” SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0780 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi ankimor IOE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke mos përcaktuar qartë detyrimet, nevojat dhe specifikimet funksionale të kontratës, duke lënë të paqartë numrin e moduleve, nën-moduleve, trajnimeve dhe shkallën e avancimeve, gjë që e bën objektin e kontratës të papërcaktuar dhe cenon përgatitjen e ofertave të përgjegjshme dhe konkurrencën e barabartë.

Përgjigje e ekspertit AK ka publikuar njoftimin për kontratë për mirëmbajtje dhe avancim të BHIS, mirëpo dokumentacioni i tenderit dhe sqarimet e dhëna më 29.07.2025 dëshmojnë se mungojnë elementet bazë të kërkesave funksionale dhe ekzekutive. Nuk është përcaktuar numri minimal i moduleve dhe nën-moduleve, nuk ka paramasa të sakta për avancimet e sistemit ekzistues, ndërsa trajnimet, ndërlidhjet me sisteme të jashtme dhe vetë funksionalitetet e reja janë lënë të definohen gjatë zbatimit. Termi “avancim” është përdorur pa qartësi, duke nënkuptuar si përmirësime të pjesshme ashtu edhe ridizajnim të plotë, pa kufi të saktë të punës. Këto mungesa e bëjnë objektin e kontratës të papërcaktuar dhe cenojnë parimin e transparencës dhe konkurrencës së barabartë.Nga këndvështrimi i inxhinierisë së softuerit, një dokument specifikimi funksional (SRS) duhet të përmbajë:kërkesat funksionale minimale;kërkesat jofunksionale për

performancë, siguri, disponueshmëri dhe përdorshmëri; use cases / user stories për secilin rol kryesor të sistemit; kriteret e pranimit dhe definition of done; modelin e të dhënave dhe ndërfaqet (API) që do të përdoren për ndërlidhje me sisteme të jashtme. Asnjë nga këto elemente nuk është përcaktuar qartë në dosjen e tenderit. Pa këto informata të sakta, nuk mund të hartohet as backlog fillestar, nuk mund të përcaktohet çfarë është minimum viable product (MVP), dhe nuk mund të planifikohet sasia e resurseve teknike e financiare. Vetë metodologjia agile, në të cilën është mbështetur arsyetimi i AK-së, kërkon që të ekzistojnë këto elemente fillestare. Agile nuk është justifikim për mungesë scope-i, por vetëm mënyrë për të zhvilluar funksionalitetet mbi kërkesa të qarta fillestare. Përdorimi i termit “sasi indikative $\pm 30\%$ ” nuk qëndron nga aspekti teknik dhe ligjor. Nëse nuk ka bazë konkrete (p.sh. përcaktim minimal i moduleve ose seanca trajnimesh me numër të personave), nuk ka asnjë vlerë devijimi $\pm 30\%$, sepse nuk dihet mbi çfarë sasive aplikohet. Si pasojë, OE-të nuk mund të përgatisin oferta të përgjegjshme, nuk mundën të kalkulojnë çmime të bazuara në punë reale dhe nuk mundën të planifikojnë resurse njerëzore e teknike. Kjo qasje krijon rrezik të madh për ekzekutimin e kontratës, mund të shkaktojë devijime serioze të kostos dhe kohës, si dhe e vendos këtë aktivitet të prokurimit në kundërshtim me nenet 9, 17, 27 dhe 28 të Ligjit për Prokurim Publik. Në përfundim, dokumentacioni i tenderit është i paplotë si nga aspekti ligjor, ashtu edhe nga aspekti teknik i inxhinierisë së softuerit. Mungesa e specifikimeve minimale, e kriterëve të pranimit dhe e backlog-ut fillestar e bën këtë proces të paqartë, subjektiv dhe të rrezikshëm për konkurrencën e ndershme. Për këtë arsye, pretendimi i OE ankues është i bazuar, dhe dosja e tenderit duhet të rishikohet e të plotësohet me specifikime të qarta funksionale dhe jofunksionale, duke siguruar transparencë dhe qartësi për të gjithë ofertuesit.

Pretendimi ankimor 2OE ankues pretendon se AK ka shkelur dispozitat e LPP-së duke parashikuar buxhet të pasaktë e të pamjaftueshëm për kontratën, pasi vlera e shpallur (432,000 €) është në disproporcion me kostot reale të tregut (mbi 650,000 € vetëm për paga), nuk reflekton ngritjen e pagave në sektorin IT dhe bie ndesh me planifikimet buxhetore paraprake. Një praktikë e tillë cenon transparencën, barazinë konkurruese dhe realizimin efektiv të kontratës.

Përgjigje e ekspertit Sipas dosjes së tenderit, AK ka përcaktuar që ky aktivitet të realizohet përmes një kontratë publike kornizë, shërbim, me vlerë të parashikuar prej 432,000 € dhe kohëzgjatje 36 muaj, e cila hyn në fuqi nga data e nënshkrimit. Eksperti sqaron se sipas nenit 16 të LPP-së, vlera e parashikuar e kontratës duhet të përfshijë çmimin përfundimtar që do të paguhet nga autoriteti kontraktues, duke llogaritur të gjitha elementet e kostos që mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, përfshirë paga, tatime, shpenzimet operative dhe çdo detyrim tjetër financiar. Kjo nënkupton se vlera e shpallur duhet të jetë reale dhe e mbështetur në të dhëna konkrete të tregut dhe të buxhetit. Në ndërlidhje me përgjigjen në pretendimin 1, eksperti sqaron se pa definim të qartë të gjitha elementeve që mbulon fushëveprimi i kontratës, parashikimi i vlerës bie në kundërshtim me nenin 16 të LPP-së, pasi është e pamundur të llogaritet në mënyrë të saktë çmimi përfundimtar. Mungesa e specifikimeve funksionale dhe teknike (numri i moduleve, shkalla e avancimeve, numri i trajnimeve, etj.) e bën këtë parashikim të paqartë dhe jo të matshëm, duke rritur rrezikun e mospërputhjes mes vlerës së kontratës dhe kostos reale të projektit. Megjithatë, eksperti sqaron gjithashtu se planifikimi buxhetor për një aktivitet të prokurimit është proces paraprak, i cili i nënshtrohet një vlerësimi të bërë nga AK në raport me nevojat dhe çmimet referente në momentin e planifikimit. Ky proces realizohet konform procedurave të planifikimit buxhetor, të përcaktuara përmes kufijve buxhetor dhe qarkoreve buxhetore të vitit paraprak, dhe është në përgjegjësi e AK. Në këtë kuptim, edhe pse buxheti i përcaktuar nga AK është në kompetencën e tij ligjore, përputhshmëria e tij me nenin 16 të LPP-së mund të vihet në pikëpyetje nëse nuk mbështetet mbi një fushëveprim të qartë dhe elemente të matshme të kontratës. Andaj pretendimi ankimor është pjesërisht i

bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri-tender Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemi BHIS-3” me nr. të prokurimit: 206-25-6449-2-1-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ri-tender Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemi BHIS-3” me nr. të prokurimit: 206-25-6449-2-1-1, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim. Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, rrjedhimisht paneli shqyrtues konstaton që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË, MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - PBC SH.P.K., PBC SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: